



Banka Boterore

Rajoni i Evropes dhe Azise Qendrore

Zyra e Tiranes

Contact: Ana Gjokutaj (355 42) 405 87/88/89

Email: Agjokutaj@worldbank.org

<http://www.worldbank.org.al>

PROGRAMI I GRANTEVE TE VOGLA NDIHMON NE FUQIZIMIN E ANGAZHIMIT QYTETAR TE GRUPEVE PA PERKRAHJE TE POPULLSISE

TIRANE – 3 qershor 2003 - Prej tri vitesh Zyra e Bankes Boterore ne Tirane po u jep grante organizatave te shoqerise civile ne kuadrin e Programit te Granteve te Vogla. Objektivi i Granteve te Vogla per kete vit ishte fuqizimi i angazhimit qytetar te grupeve te menjanuara dhe te rrezikuara te popullsisë per te patur edhe ato autoresi mbi proceset e zhvillimit.

Bordi i jashtem keshillimor, i perbere nga perfaqesues te donatoreve dhe organizatave nderkombetare te angazhuara me shoqerine civile, dhe komiteti i brendshem per perzgjedhjen e granteve, i perbere nga punonjes te zyres se Bankes Boterore, shqyrtuan me kujdes 83 propozime projektesh dhe perzgjodhen 12 propozime te vlefshme per financim. Shuma e pergjithshme e akorduar per kete projekt per vitin 2003 eshte 45,000 \$ ndersa shuma per cdo projekt varion nga 2,500\$ deri 5,200\$. Shperndarja gjeografike e propozimeve perفشin gjithë vendin qe nga Shkodra, Puka, Durresi, Tirana, Fieri e Gjirokastra.

Fitues te granteve per kete vit u shpallen organizatat e meposhtme me keto projekte:

- ❑ Fuqizimi i grave ne zonat rurale te Pukes per t'i bere ato me aktive ne shoqeri, "*Grate intelektuale*", Puke
- ❑ Organizimi i nje seri debatesh mbi problemet sociale te moshes se trete me pjesemarrje te pushtetit lokal, shoqerise civile dhe vete te moshuarve, *AMIV*, Gjirokastra
- ❑ Prodhimi i 24 episodeve te telenoveles "Rruga me pisha" mbi ndergjegjesimin e publikut per trafikimin e grave dhe transmetimi i tyre ne Radio Tirana, Fondacioni "*Rruga me pisha*", Tirana
- ❑ Mbeshtetje per femijet e rrezikuar nga trafikimi dhe prinderit e tyre, "*Unioni rinor i te drejtave te njeriut*", Tirana
- ❑ Trajnim per lidership per grate rome, *Shoqata e Grave te reja kristiane*, Tirana

- ❑ Publikimi ne shqip i librit “E drejta per te thene”, botim i Institutit te Bankes Boterore me qellim perdorjen e tij gjate trajnimeve me gazetares shqiptare ne Shqiperi, Kosove dhe Maqedoni, *"Instituti shqiptar i medias"*,
- ❑ Rritja e perfshirjes se grupeve te perjashtuara ne vendimmarrje ne zonen e Koder-Kamzes, *"Integrim ne komunitet"*, Tirana
- ❑ Promovimi i te drejtave te femijeve dhe nxitja e bashkekzistences ne harmoni te femijeve rome dhe atyre jorome, *"Dyert e se ardhmes"* Fier
- ❑ Sensibilizimi i institucioneve vendimmarrese rreth veshtiresive te aktivitetit prodhues te familjeve te varfera ne zonat rurale te Shkodres, Lezhes dhe Elbasanit, me qellim krijimin e kushteve nxitese per aktivitetin e tyre, *QKZH*, Tirana,
- ❑ Prodhimi i dy dokumentareve televizive, pjese e serialit “Tunel” me qellim rritjen e kapaciteteve te grupeve te rrezikuara per te influencuar opinionin publik dhe negociuar me pushtetin qendror dhe ate lokal qe t’u pergjigjen shqetesimeve te tyre, *ASET*, Tirana, 5,000\$.
- ❑ Eliminimi i punes se femijeve dhe perfshirja e shoqerise ne parandalimin e ketij fenomeni, *"European Children's Trust"*, Shkodra
- ❑ Ndergjegjesimi i opinionit dhe vecanerisht parlamentareve per traktatet dhe konventat dy dhe shumepaleshe ne lidhje me te drejtat e femijeve, *International Social Services*, Zyra per Shqiperine

Programi i Granteve te Vogla i Bankes Boterore eshte krijuar per te nxitur dialogun dhe shperndarjen e informacionit mbi zhvillimin, si edhe per te thelluar partneritetin me shoqerine civile.

-###-